



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 32, datë 28.04.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TOTAL PREJ 10,033,344 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TERRENIT SPORTIV NË SHKOLLËN 9 VJEÇARE “FSHAT RINIA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE KATUND I RI, DURRËS, SI NJË KONTRIBUT I PËRBASHKËT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE WORLD VISION ALBANIA

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 8788/2001, “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar, VKB-së nr. 66, datë 24.05.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit total prej 3 074 534 lekë për zbatimin e projektit “Rikualifikimi i këndit të lojërave dhe krijim hapësire rekreative tek kopshti “Neim Babameto”, Durrës” si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe Shoqatës “World Vision”, VKB-së 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024”, VKB-së 21, datë 31.03.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti 2021, të cilat i shtohen buxhetit të vitit 2022 të Bashkisë Durrës” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe të Drejtorisë së Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Dhënie e miratimit të nënshkrimit të marrëveshjes midis Bashkisë Durrës dhe Shoqatës World Vision Albania për zbatimin e projektit “Rikonstruksioni i terrenit sportiv në shkollën 9 vjeçare “Fshat Rinia”, Njësia Administrative Katund i Ri, Durrës”.

2. Miratimin e përdorimit të fondit total prej prej 10,033,344 lekë për zbatimin e projektit “Rikonstruksioni i terrenit sportiv në shkollën 9 vjeçare “Fshat Rinia”, Njësia Administrative Katund i Ri, Durrës, si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe World Vision Albania.
3. Ky fond do të mbulohet si kontribut i përbashkët në vlerën 8 080 092 lekë nga Shoqata “World Vision Albania” dhe në vlerën 1 953 252 lekë nga ana e Bashkisë Durrës, fond i cili do të merret nga fondi rezervë i miratuar me VKB-në 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2022-2024”.
4. Shfuqizimin e VKB-së nr.66, datë 24.05.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit total prej 3 074 534 lekë për zbatimin e projektit “Rikualifikimi i këndit të lojërave dhe krijim hapësire rekreative tek kopshti “Neim Babameto”, Durrës” si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe Shoqatës “World Vision Albania”.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare si dhe Njësia e Prokurimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.04.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 395/prot.
7

Durrës, më 06.05.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.32 datë 28.04.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondit total prej 10.033.344 lekë për zbatimin e projektit “Rikonstruksioni i terrenit sportiv në shkollën 9-vjeçare “Fshat Rinia”, Njësia Administrative Katund i Ri, Durrës si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe World Vision Albania”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

